

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
“AGRO ORGANIC INTERNACIONAL” SHPK

Neni 1
Ortaku themelues

- 1.1 Shoqëria **“AGRO ORGANIC INTERNACIONAL” SHPK** themelohet nga Ortaku i Vetëm :
- Gëzim Beqaj, i biri I Kujtimit dhe I Ferjates, i datëlindjes 1960, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, Rr. “Dervish Hima”, pallati prapa Rezidences Franceze, apartamenti 3A/1, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit ID nr.035876281 dhe numër personal G00220166B, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2
Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është **“AGRO ORGANIC INTERNACIONAL” SHPK**

Neni 3
Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe themelohet në përputhje me legjislacionin shqiptar tregtar.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar tregtar.

Neni 4
Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria **“AGRO ORGANIC INTERNACIONAL” SHPK** do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin e saj, legjislacionin tregtar si dhe legjislacionin ne fuqi për çështje që nuk parashikohen nga Statuti dhe legjislacioni tregtar.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendren Kombëtar të Biznesit.
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pacaktuar.



Neni 6 Selia

6.1 Selia e shoqërisë është në adresën:

Rr. "Abdyl Frashëri", Kulla "EGT", kati i 7^e, apartamenti nr. 21. Kodi Postar 1001, Tiranë

Neni 7 Objekti

7.1 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të përfshijë cdo lloj veprimtarie të ligjshme që do të konsiderohet fitimprurëse për shoqërinë e kryesisht do të konsistojë në :

- ✓ Import-eksport, dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë, i produkteve dhe nënprodukteve të thjeshta apo të përpunuara bujqësore e blegtorale dhe bimëve mjekësore e eterovajore, farërave dhe fidanëve, brenda dhe jashtë vendit;
- ✓ kultivimi i produkteve bujqësore dhe bimëve mjekësore e eterovajore
- ✓ grumbullimi, magazinimi përpunimi i produkteve dhe nënprodukteve bujqësore e blegtorale, bimëve mjekësore e eterovajore dhe farërave dhe fidanëve;
- ✓ mbarështrimi i blegtorisë të llojeve të ndryshme të gjëdhëve;
- ✓ grumbullimi, magazinimi, eksportimi i produkteve

7.2 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 8 Kapitali


8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 (njëmijë) lekë.

8.2 Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë e cila zotërohet 100% nga ortaku i vetëm.

Neni 9 Asambleja e Ortakëve

9.1 Asambleja e Ortakëve është organi më i lartë vendimor i shoqërisë.

9.2 Asambleja e Ortakëve drejton veprimtarinë e shoqërisë nëpërmjet marrjes së vendimeve. Mbledhjet e Asamblesë mund të jenë të zakonshme ose të jashtëzakonshme.



Neni 10
Administrimi

- 10.1 Administrator i shoqërisë është Z. Gezim Beqaj.
- 10.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të saj në përputhje me vendimet dhe udhëzimet e Asamblesë së Ortakëve.
- 10.3 Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë në përputhje me kompetencat e tij parashikuar në statut.

Neni 11
Ekspertët kontabël të autorizuar

- 11.1 Në mbledhjen e Asamblesë kur është e nevojshme, Ortaku i Vetëm mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të autorizuar.

Neni 12
Viti financiar

- 12.1 Viti financiar i shoqërisë përpunohet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 22.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit Tiranë dhe përfundon më 31 Dhjetor 2022.

Neni 13
Bilanci. Kontabiliteti.

- 13.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit Mars të vitit pasardhës.
- 13.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën shqipe dhe në monedhë shqiptare. Për operacione të vecanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të vecanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

Neni 14
Likuidimi

- 14.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.
- 14.2 Me vendimin e Asamblesë së Ortakëve caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.



Neni 15
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 15.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare ose nga organet shqiptare te arbitrazhit, ne qofte se nuk jane zgjidhur nepermjet nje procesi ndermjetesimi.

Neni 16
Klauzolë mbyllëse

- 16.1 Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe me fuqi të njëjtë ligjore.

ORTAKU I VETËM I SHOOËRISË

GËZIM BEQAJ

Gëzim Beqaj


dh. 13/04/2022